KEK
KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA [illegible] KORPORACIJA d.d.
09 -11- 2026
Nr. 8042
PRISHTINË - A

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe plotësim-ndryshimit të UA nr. 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, si dhe në bazë të Kodit të Punës nr. 804, datë 28.01.2025, të KEK sh.a., dhe nevojës emergjente të paraqitur për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Prodhimit të qymyrit , Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 09.11.2026, që të publikojë konkursin për pozitat:

KONKURS

Titulli i pozitës:	**Inxhinier i Elektroenergjetikës**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi i aktit të emërimit të punës:	Sipas Ligjit të Punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim-ndryshimit të UA 03/2024 dhe Kodit të Punës
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton: Koordinatorit, Inxhinierit Operativ, Udhëheqësit të Sektorit të Kryerjes-Inxhinieringut Elektrik, Menaxherit të Departamentit të Mirëmbajtjes
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vit me mundësi vazhdimi, puna provuese 12 muaj
Koeficienti/Paga:	929.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	5
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – Divizioni i Prodhimit të Qymyrit, Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Bartësi i vendit të punës ka për detyrë të realizojë të gjitha punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me planifikimin e materialit, fuqisë punëtore, mbikëqyrjen deri në realizimin e plotë të punëve në mënyrë që të mundësohet puna në sistemet e djerrinës apo qymyrit. Bashkëpunon me Koordinatorët e Kryerjes Elektrike.Varësit e drejtpërdrejtë janë inxhinieri i kryerjes, tekniku i elektrikës, prijësit e elektrikës në pajisje. Harton harmonogramet, planifikon fuqinë punëtore dhe mekanizmin e nevojshëm për kryerjen e riparimeve në sistem. Bën kërkesa për punë në pajisjet që i mirëmbanë. Lexon raportet nga Inspektorët e SI&MKZ dhe merr masat e nevojshme për të eliminuar vërejtjet e dhëna. Në bashkëpunim me prijësit në PX bën planifikimet e nevojshme për riparime. Bazuar në shpenzimet vjetore për pjesë rezervë dhe riparime harton planin e furnizimit të cilit ia dorëzon Udhëheqësit të Sektorit të Inxhinieringut, prej nga hartohet buxheti në kuadër të Departamentit të Mirëmbajtjes. Është përgjegjës për eliminimin e defekteve afatgjata në PKX. E bën identifikimin e pjesëve ekzistuese për pajisjet duke shfrytëzuar mundësinë për zëvendësimin e tyre me pajisje të reja me qëllim të rritjes së shkallës së shfrytëzimit të pajisjeve. Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave në fuqi dhe ligjit përkatës. Kontrollon librat amë të P.K.X. dhe të njëjtat i nënshkruan. Kryen punë të tjera konform kualifikimit profesional të cilat i caktohen nga Inxhinieri Operativ, Udhëheqësi i Sektorit të Kryerjes Elektrike apo Menaxheri i Departamentit të Mirëmbajtjes së Mihjeve. Bën kërkesat e punës, autorizon teknikun e elektrikes për tërheqje të materialit në depo.

Kualifikimet dhe profili:
Baçelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, drejtimi energjetike (ose Inxhinier i Elektroteknikës – SHLP).
Një (1) vit përvojë pune. Njohja e aplikacioneve softuerike (PLC) është përparësi. Aftësi organizative të planifikimit, udhëheqjes dhe implementimit të punëve. Aftësi për punë të pavarur dhe bashkëpunim me personelin.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:
Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin** e shkarkuar nga ueb-faqja e KEK-ut e plotësoni dhe pas plotësimit, duhet ta ngarkoni në formën e aplikimit online te vegëza: "**Ngarko aplikacionin e plotësuar**", vetëm në formatin tonë që gjendet në ueb-faqen e KEK-ut.
- **Dëshminë për kualifikimin tuaj,** përkatësisht **diplomën e Baçelorit,** e skanoni në një dokument të vetëm (format .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe e dërgoni te vegëza **"Dëshmia e kualifikimit"**.
- **Dëshminë e përvojës së punës** me **kontratë, vërtetim** apo **trust** mbi përvojën e punës, i ngarkoni në aplikimin online te vegëza **"Ngarko dëshmitë e përvojës së punës"**.

Nëse diploma është fituar jashtë vendit, duhet të dorëzohet vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo akti që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Titulli i pozitës:	**Inxhinier i elektronikës (për punë në ndërrime)**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi i aktit të emërimit të punës:	Sipas Ligjit të Punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim-ndryshimit të UA 03/2024 dhe Kodit të Punës
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Udheheqësit te sektorit , Koordinatorëve të elektronikës
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vit me mundësi vazhdimi, puna provuese 12 muaj
Koeficienti/Paga:	929.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	5
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – Divizioni I Prodhimit te Qymyrit - Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës Është përgjegjës për gatishmërinë teknike për punë të pajisjeve elektronike. Është përgjegjës për zgjidhjen e problematikave vijuese si në zyrë ashtu edhe në terren në Departamentin e Mirëmbajtjes, mbi bazat e normave (standardeve) teknike adekuate, rregullave të KEK-ut të njohura me ligj dhe brenda kornizës së autoritetit dhe detyrave të tij. Është i obliguar të udhëheq librin e ndërrimeve të të nënvarësve dhe sanksionon vonesat dhe lëshimin e vendit të punës pa leje.Në fillim dhe në mbarim të ndërrimit merr pjesë në raportin e punës që të njoftohet me problemet dhe detyrat që duhet të kryhen.Është përgjegjës që së bashku me personelin e elektronikës industriale të analizojë ndalesat e ndryshme në bazë të natyrës së prishjeve.Është përgjegjës për diagnostikimin (përcaktimin) e prishjeve të ndryshme dhe, në rast të pamundësisë së diagnostikimit të defektit, konsultohet dhe kërkon ndihmë nga koordinatori i elektronikës. Është përgjegjës për informimin dhe raportimin e çfarëdo incidenti dhe fatkeqësie në punë tek koordinatori për elektronikë.Është përgjegjës për moslejimin e improvizimeve dhe urëzimeve të ndryshme në pajisjet elektronike.Është përgjegjës për implementimin e masave të obligueshme për sigurinë e personelit dhe sigurinë fizike të stabilimenteve dhe pajisjeve elektronike.Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave në fuqi dhe ligjit përkatës. Kontrollon librat amë të P.K.X. dhe të njëjtat i nënshkruan.Përpilon udhëzimet për punë për stafin e Kryerjes Elektrike.Obligohet që të krijojë kushtet për realizimin e punëve të planifikuara gjatë ndalesave. Ofron mbështetje profesionale, ekipore dhe logjistike për ekipet të cilat i mbikëqyr.Është përgjegjës për eliminimin e defekteve në PKX.Është përgjegjës për krijimin e kushteve dhe aplikimin e rregullave për mbrojtje dhe siguri në punë.Kryen punë të tjera konform kualifikimit profesional të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Sektorit të Kryerjes Elektrike apo Menaxheri i Departamentit të Mirëmbajtjes së Mihjeve. Përveç përgjegjësisë së vet duhet t'i bartë detyrat dhe përgjegjësitë individuale tek nënvarësit e tij (prijësit dhe mjeshtrit).

Kualifikimet dhe profili:

Baçelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike (drejtimi elektronikë – automatikë). Së paku 1 vit përvojë pune . Njohja e aplikacioneve softuerike PLC. Njohja e mirë e punës me kompjuter. Aftësi organizative të planifikimit, udhëheqjes dhe implementimit të punëve. Aftësi për punë të pavarur dhe bashkëpunim me ekipin.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin** e shkarkuar nga ueb-faqja e KEK-ut e plotësoni dhe, pas plotësimit, duhet ta ngarkoni në formën e aplikimit online te vegëza: **"Ngarko aplikacionin e plotësuar"**, vetëm në formatin tonë që gjendet në ueb-faqen e KEK-ut.
- **Dëshminë për kualifikimin tuaj**, përkatësisht **diplomën e Baçelorit**, e skanoni në një dokument të vetëm (format .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe e dërgoni te vegëza **"Dëshmia e kualifikimit"**.
- **Dëshminë e përvojës së punës** me **kontratë**, **vërtetim** apo **trust** mbi përvojën e punës, i ngarkoni në aplikimin online te vegëza **"Ngarko dëshmitë e përvojës së punës"**.

Nëse diploma është fituar jashtë vendit, duhet të dorëzohet vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo akti që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Titulli i pozitës:	**Inxhinier për makineri**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi i aktit të emërimit të punës:	Sipas Ligjit të Punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim-ndryshimit të UA 03/2024 dhe Kodit të Punës
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton: Koordi. makinerisë, udhëh. të sektorit, Menaxherit të Dep Mirëmbajtjes apo te Serviseve
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vit me mundësi vazhdimi, puna provuese 12 muaj
Koeficienti/Paga:	929.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	15
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – Divizioni I Prodhimit te Qymyrit - Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Bartësi i vendit të punës Parashikon dhe propozon buxhetin vjetor për nevoja të Dep. të Mirëmbajtjes apo Serviseve. Është përgjegjës për përgatitjen e rregullave për mirëmbajtje dhe riparime kapitale të pajisjeve kryesore makinerike për prodhim.Përgatit dokumentacionin teknik konform me ndryshimet në teren. Bën inspektimin, përgatit listën për defektazhen dhe kërkesën mbi pjesët e nevojshme për riparimin e pajisjes së caktuar. Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave në fuqi dhe ligjit përkatës. Kontrollon librat amë të P.K.X. dhe të njëjtat i nënshkruan.Është i obliguar që të bashkëpunojë me kolegë dhe t'i aftësojë – këmbëj përvojën e punës me punëtorët e rinj. Është i obliguar të mbajë evidencë për fillimin dhe mbarimin e punëve, dhe plotëson dokumentacionin në fund të aktiviteteve.Obligohet që të bëjë raport javor me shkrim për punët e kryera, dhe në bashkëpunim me koordinatorë kompleton dokumentacionin.Kryen punë dhe detyra të tjera konform kualifikimit profesional që caktohen nga udhëheqësi ose menaxheri në funksion të realizimit të detyrave të parashtruara.Në bashkëpunim me Inxh. Operativ, Inxh. kryerjes dhe personat tjerë përgjegjës propozon afatet kohore të riparimit të pajisjeve dhe përpilon harmonogramet e punës për riparim. Vendi i punës është në zyrë dhe në teren.Punon edhe punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë. Autorizohet të bëjë kontrollin e pajisjes në teren si dhe t'i përgatisë masat konform situatës. Të hap urdhëresa pune në FPX-Palaj dhe P. Makinerisë në Bardh, urdhëresa teknologjike për riparimet në teren dhe të përcjell realizimin e tyre. Pas çdo riparimi të pjesshëm apo gjeneral, bën raport me shkrim mbi gjendjen e pajisjes përkatëse, i cili në vazhdim do të konsiderohet si pjesë përbërëse e dokumentacionit.

Kualifikimet dhe profili:
Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Mekanike (drejtimi konstruksion ose prodhim). Së paku 1 vit përvojë pune.Të ketë aftësi organizative për kryerjen e punëve. Të ketë aftësi për punë ekipore.Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.Aftësi të përdorimit të kompjuterit, njohuri për softuerët profesionalë. Kërkohet të ketë aftësi të shkëlqyeshme profesionale – teknike dhe koordinim ekipor të punës.Të ketë cilësi të dalluara organizative, të jetë komunikativ, të ketë aftësi pune i pavarur dhe në ekip.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:
Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin** e shkarkuar nga ueb-faqja e KEK-ut e plotësoni dhe, pas plotësimit, duhet ta ngarkoni në formën e aplikimit online te vegëza: "**Ngarko aplikacionin e plotësuar**", vetëm në formatin tonë që gjendet në ueb-faqen e KEK-ut.
- **Dëshminë për kualifikimin tuaj**, përkatësisht **diplomën e Bachelorit**, e skanoni në një dokument të vetëm (format .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe e dërgoni te vegëza "**Dëshmia e kualifikimit**".
- **Dëshminë e përvojës së punës** me **kontratë, vërtetim** apo **trust** mbi përvojën e punës, i ngarkoni në aplikimin online te vegëza "**Ngarko dëshmitë e përvojës së punës**

Nëse diploma është fituar jashtë vendit, duhet të dorëzohet vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo akti që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Titulli i pozitës:	**Manipulues i shiritave transportues, Manipulues i hinkës fushore dhe Manipulues i kabinës 2**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës (Divizoni i Prodhimit të Qymyrit)
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA01/2024
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Prijësit të etazhës, Inxhinierit të ndërrimit, Udhëheqësit të sektorit dhe Menaxherit të Departamentit të Djerrines dhe Serviseve,
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	Minimumi 766.00 Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	**30**
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – Divizioni i Prodhimit te Qymyrit - Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Bartësi i vendit të punës **Manipulues i shiritave transportues** ka për obligim të përcjellë me vëmendje punën e pajisjeve ngasëse të stacionit veprues – shiritit transportues gjatë ndërrimit. Kontrollon pajisjet përcjellëse të stacionit veprues dhe pastrimin e tij.
Duhet të ketë njohuri të mjaftueshme në lidhje me shiritat e gomuar (të tenton të bëjë centrimin) në qoftë se shiriti devijon majtas apo djathtas, të lajmëron përgjegjësit e Departamentit të Mirëmbajtjes apo te Djerrines. Komandon me pajisjet ngasëse të stacionit veprues – shiritit transportues. Është i obliguar që para çdo startimi të stacionit veprues – shiritit transportues, të shtypë sirenën alarmuese.
Në raste të rrezikut nga zjarri duhet të din të përdorë aparatet për fikje të cilat janë të vendosura në çdo stacion veprues apo shirit transportues.

Bartësi i vendit të punës **Manipulues i hinkës fushore** para lëshimit në punë të shiritit transportues është i obliguar të vërteton se a janë rrotat e hinkës fushore në binar, që shiriti të mos prek konstruksionin, që tereni për transport të hinkës fushore të jetë i pastër, që kablloja e bllokadës të mos jetë e këputur apo e dëmtuar. Obligohet që rregullisht të kujdeset për pastrimin e pesë fushave para dhe prapa hinkës fushore, stacionit kthyes, të kujdeset për funksionimin e gërryesit "V", të gërryesit të tamburit dhe lëvizjes së shiritit brenda kufijëve të lejuar mbi tambur.

Është i obliguar që t'ia dorëzon në gjendje të rregullt ndërrimit vijues hinkën fushore dhe stacionin kthyes dhe t'ia paraqesë gojarisht të gjitha problemet që janë paraqitur gjatë turnit (pranim/dorëzimi i detyrës). Pastrimi përrreth si dhe nën hinkën ngarkuese dhe stacionin kthyes bëhet kur shiriti transportues është i ndalur – jashtë punës, për shkak të sigurisë. Manipuluesi i hinkës fushore nuk guxon të hyp në vende të rrezikshme dhe t'iu ekspozohet rreziqeve atje ku mund t'i kanoset rreziku për jetë, posaçërisht kur shiriti vetëlëvizës dhe shiriti transportues janë në punë. Për pastrimin e pajisjeve dhe vendeve të caktuara manipuluesi duhet të ketë vegla adekuate. Është i detyruar t'i njoh sinjalet e zërit dhe të dritës të cilat ia jep manipuluesi i shiritit vetëlëvizës dhe ato: Një herë shkurt "Ndal"; dy herë shkurt "Mbrapa"; tri herë shkurt "Përpara"; Sinjali me ndërprerje "Kalim i lirë". Sipas nevojës me urdhëresë të udhëheqësve, pastron edhe në vendet tjera të punës. Përgjigjet për moszbatimin e plotë të rregullave të mbrojtjes teknike në pajtim me Ligjet në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative, me theks të veçantë atyre nga siguria në punë, si dhe Rregulloret e brendshme të KEK sh.a.

Bartësi i vendit të punës **Manipulues i kabinës 2 Er,** para fillimit të punës duhet të pajiset me të gjitha mjetet e mbrojtjes në punë. Pas leximit të librit të pranim/dorëzimit nga turni i mëparshëm, kontrollon pajisjet sinjalizuese dhe komanduese të kabinës. Të gjitha prishjet të cilat eventualisht ndodhin, manipuluesi lajmëron prijësin e etazhës dhe kërkon prej shërbimit për mirëmbajte që të evitohen para fillimit të punës.
Prishjet që nuk arrihet të evitohen brenda turnit do t'i shënon në ditarin e punës dhe do të kërkon evitimin e tyre. Është i obliguar t'i njoh sinjalet e zërit dhe dritës: Një herë shkurt "Ndal"; dy herë shkurt "Mbrapa"; tri herë shkurt "Përpara"; Sinjali me ndërprerje "Kalim i lirë". Në fillim të punës duhet ta vërteton lidhjen me Kabinën 1. Gjatë transportit të Ekskavatorit, manipuluesi i kabinës 2 kujdeset për pozitën e kabinës kurse gjatë punës kujdeset për përqëndrimin e punës së kabinës 2 dhe ngarkesës në SHVL ose në ngarkesën direkt në hinkën fushore, e cila gjendet në shiritin transportues të etazhës. Rregullisht kontrollon gjendjen e instrumenteve (V dhe A - metrit). Punën e kabinës 2 e harmonizon me karakteristikat tekniko-teknologjike të Ekskavatorit rotorik të cilat manipuluesi duhet t'i njoh. Gjatë transportit të Ekskavatorit rregullisht kujdeset edhe për kablon furnizuese. Gjersa Ekskavatori punon, manipuluesi i kabinës 2 nuk guxon ta lëshojë vendin e punës ose të punon tjera punë të cilat e pengojnë atë. Obligohet që të zbaton plotësisht rregullat e mbrojtjes teknike në punë, Ligjin e xehetarisë si dhe rregullat e KEK-ut të harmonizuara me Ligj. Përgjigjet për mirëmbajtjen e pastërtisë së krahut II, rrethanën (krahut III dhe IV) si dhe sipas urdhëresës së prijësit, udhëheqësit të sektorit, inxhinierit të ndërrimit dhe Menaxherit sipas nevojës, duhet të pastron edhe vendet tjera.
Sipas nevojave të prodhimit dhe urdhëresës gojore apo me shkrim nga prijësi i etazhës, inxhinieri i ndërrimit, udhëheqësi i sektorit apo Menaxheri, punëmarrësi duhet të punon edhe në vend tjetër të punës në kuadër të profesionit.
Është i autorizuar të manipulon me pajisjet komanduese të stacionit veprues – shiritit transportues gjatë ndërrimit. Të vepron sipas rregullave të mbrojtjes në punë në pajtim me Ligjet në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative, e me theks të veçantë atyre nga siguria në punë, si dhe Rregulloret e brendshme të KEK sh.a. Të mos lejon qasje në kabinën komanduese (stacionin veprues) të personave të paautorizuar. Vendi i punës do të jetë në Departamentin e Serviseve, Djerrinës, Qymyrit (varësisht ku sistemohet punëtori).
Në rast rreziku për shiritin ose jetën e tij ose të të tjerëve, duhet menjëherë ta ndalon shiritin me anë të një ndërprerësi (pulle - taste) të vendosur në distanca jo të mëdha në shirit transportues për ndalim të dhunshëm dhe për këtë ta njofton Prijësin e etazhës. Nëse vëren se shiriti transportues shkon me një anë nga tamburi kthyes, është i autorizuar që këtë ta rregullon vetë nëpërmjet rregullatorit ose ta njofton axhustatorin gjegjësisht prijësin tij.
Në rast rreziku për vetë manipuluesin si dhe në raste lëndimesh në sektorin e tij të punës, manipuluesi e ndalë punën deri të kryhen hetimet e shkakut të aksidentit. Është i autorizuar që të mos e lëshojë kabinën 2 në punë nëse gjendja e pajisjes nuk i plotëson kushtet kryesore të rregullave teknike për punë. **I raporton**: Prijësit të etazhës, Inxhinierit të ndërrimit, Udhëheqësit të sektorit dhe Menaxherit të Departamentit përkatës.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Shkollimi: Të ketë të kryer shkollën e mesme profesionale, Drejtimi i xehtarisë.
Profili: Teknik i xehtarisë, Teknik i minierave.
Të ketë integritet, etikë dhe ndershmëri profesionale, njëherësh duhet të jetë komunikues efikas;
Të ketë shkathtësi të mira personale dhe komunikuese si dhe duhet të jetë i/e aftë për punë ekipore dhe individuale.

Dokumetet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

a. Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **"Ngarko Aplikacionin e plotësuar"**
b. Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme teknike - Drejtimi Xehtari** (ose **Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme teknike - drejtimi xehetari ose diplomën Teknik i Minierave**) e skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza **"Ngarko dëshmitë e kualifikimit".**

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Titulli i pozitës:	**Axhystator i kategorisë I**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi i aktit të emërimit të punës:	Sipas Ligjit të Punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim-ndryshimit të UA 03/2024 dhe Kodit të Punës se Kek-ut
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Prijësit të ekipit, inxhinierit përgjegjës të shërbimit, koordinatorit

Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vit me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj
Koeficienti/Paga:	796.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	15
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – Divizioni I Prodhimit te Qymyrit - Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit te punës eshtë përgjegjës për gjendjen teknike, zgjidhjen e problemeve të lëmisë mekanike dhe për gatishmërinë teknike të pajisjeve që i mirëmban. Bashkëpunon me: Axhustatorët në pajisje, në sistem dhe axhustatorin e ndërrimit.Është përgjegjës për aplikimin e rregullave të punës dhe mirëmbajtjen operative mekanike. Evidenton problematikat në pajisje dhe eviton prishjet që paraqiten. Është përgjegjës për ruajtjen e mjeteve dhe veglave të punës në mënyrë që ato të jenë të gatshme kur kërkohet përdorimi i tyre. Është përgjegjës për eliminimin e defekteve mekanike në pajisje konform kualifikimit profesional.Kujdeset për pastrimin e veglave dhe pajisjeve të punës dhe ruajtjen e tyre. Është i obliguar që të njoftojë udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë në rast të shkaktimit të ndonjë dëmi gjatë riparimit nga ana e tij, si dhe për dëmtimin e veglave dhe pajisjeve të cilat i përdorë gjatë riparimeve në mirëmbajtje. Obligohet që të bashkëpunojë me të gjitha shërbimet në kuadër të sektorit.Kryen punë të tjera konform kualifikimit profesional të cilat i caktohen nga Prijësi i Ekipit, Inxhinieri Operativ, Udhëheqësi i Sektorit të Kryerjes Mekanike. I ka të gjitha të drejtat dhe obligimet në bazë të ligjit dhe akteve normative të KEK-ut, konform kualifikimit profesional.

Kualifikimet dhe profili:

Teknik i makinerisë ose axhustator .

Përdorimi i pajisjeve të punës për matje (metër, nonius etj.).Aftësi për punë të pavarur dhe bashkëpunim ekipor

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin** e shkarkuar nga ueb-faqja e KEK-ut e plotësoni dhe, pas plotësimit, duhet ta ngarkoni në formën e aplikimit online te vegëza: **"Ngarko aplikacionin e plotësuar"**, vetëm në formatin tonë që gjendet në ueb-faqen e KEK-ut.
- **Dëshminë për kualifikimin tuaj**, përkatësisht **diplomën e shkollës së mesme**, e skanoni në një dokument të vetëm (format .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe e dërgoni te vegëza **"Dëshmia e kualifikimit"**.

Nëse diploma është fituar jashtë vendit, duhet të dorëzohet vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo akti që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Titulli i pozitës:	**Lubrifikues**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi i aktit të emërimit të punës:	Sipas Ligjit të Punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim-ndrys. UA 03/2024 dhe Kodit të Punës
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton prijësit, inxhinierit dhe koordinatorit te makinerisë.
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vit me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj
Koeficienti/Paga:	796.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	5
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – Divizioni I Prodhimit te Qymyrit - Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i punës kryen të gjitha punët rreth lubrifikimit dhe mirëmbajtjes preventive dhe vijuese të pajisjeve dhe stabilimenteve për lubrifikim, punon sipas urdhëresave dhe detyrave që ia parashtron eprori i tij i drejtpërdrejtë – prijësi i makinerisë për lubrifikim. Po ashtu është përgjegjës për implementimin (aplikimin) e masave të obligueshme për sigurinë e personelit si dhe sigurinë fizike të makinave. Bashkëpunon me përgjegjësit-inxhinierët e kryerjes dhe Departamentet tjera në kuadër të DPQ-së. Bashkëpunon ngushtë profesionalisht me mjeshtrit, prijësin dhe teknikun e lubrifikimit.Është i detyruar të zbatojë urdhëresat e drejtpërdrejta rreth lubrifikimit dhe është përgjegjës për lubrifikimin normal të pajisjeve dhe stabilimenteve për lubrifikim në PKX. Është i detyruar të përmbahet afateve të lubrifikimit të parashtruara sipas afateve të dhëna nga eprorët e tij dhe njëkohësisht evidentohet koha kur është punuar lubrifikimi sipas kohës së paraparë në diagram. Kontrollon në mënyrë permanente punën e pajisjeve dhe stabilimenteve për lubrifikim dhe është drejtpërdrejt përgjegjës për funksionimin normal të tyre. Kujdeset për përdorimin dhe furnizimin adekuat me lubrifikante sipas sasive dhe llojit, shfrytëzimin racional të tyre dhe bashkëpunon ngushtë me mjeshtrin e lubrifikimit në lidhje me evitimin e prishjeve dhe të metave teknike në sistemin e lubrifikimit.Zbaton urdhëresat dhe detyrat që kërkohen nga prijësi për lubrifikim, me të cilat bashkëpunon profesionalisht në lidhje me zgjedhjen e problemeve të ndryshme në lëmin e lubrifikimit.Kontrollon la sasitë së vajit nëpër reduktor (kontrollin e nivelit të vajit), të bëjë kontrollet e përhershme të vendeve kritike dhe me rëndësi vitale të lubrifikimit si (kushinetat) në boshtet të cilindrave ngasës, shkarkues, kthyes, shtytës, litareve të çeliktë etj. Është i obliguar

që të kryejë punë tjera në kuadër të aftësive profesionale dhe kualifikimit që posedon dhe që rrjedhin nga problematika e vendit. Ka të drejtë të kërkojë zbatimin e masave mbrojtëse në punë gjatë intervenimeve në evitimin e prishjeve në sistemin e lubrifikimit dhe në punët e tyre në kuadër të lubrifikimit. Është i obliguar të përdorë mjetet mbrojtëse personale në punë. Është i obliguar të udhëheqë ditarin e punës. Jep propozime gojore dhe me shkrim inxhinierit përgjegjës në lidhje me zgjidhjen e problemeve të caktuara teknike dhe organizative, jep udhëzime të shfrytëzimit racional. Punon edhe punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.Eshtë i autorizuar të propozojë prijësit zgjidhje adekuate për lubrifikim në lidhje me zgjidhjen e problemeve.

Kualifikimet dhe profili:
Lubrifikues – axhustator
Me 2 vite përvojë pune në lubrifikim. Kërkohet të ketë aftësi të shkëlqyeshme profesionale – teknike dhe koordinim ekipor të punës. Kërkohet të ketë aftësi të shkëlqyeshme profesionale, për lubrifikues dhe koordinim ekipor të punës. Kërkohet të ketë aftësi të shkëlqyeshme profesionale – teknike dhe koordinim ekipor të punës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:
Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin** e shkarkuar nga ueb-faqja e KEK-ut e plotësoni dhe, pas plotësimit, duhet ta ngarkoni në formën e aplikimit online te vegëza: **"Ngarko aplikacionin e plotësuar"**, vetëm në formatin tonë që gjendet në ueb-faqen e KEK-ut.
- **Dëshminë për kualifikimin tuaj,** përkatësisht **diplomën e shkollës së mesme,** e skanoni në një dokument të vetëm (format .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe e dërgoni te vegëza **"Dëshmia e kualifikimit"**.
- **Dëshminë e përvojës së punës** e argumentoni me **trust**,vertetim apo kontrat pune i ngarkoni në aplikimin online te vegëza **"Ngarko dëshmitë e përvojës së punës"**.

Nëse diploma është fituar jashtë vendit, duhet të dorëzohet vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo akti që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Titulli i pozitës:	**Punëtor Fizik**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	16-09.11.2026
Tipi i aktit të emërimit të punës:	Sipas Ligjit të Punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim-ndrysh. UA 03/2024 dhe Kodit të Punës
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton prijësit te ekipit per pastrim
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vit me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj
Koeficienti/Paga:	715.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	10
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës – TCA, Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Bartesi i vendit te punës i raporton prijësit te ekipit per pastrim. Punëtori fizik është i detyruar të pastrojë nga materiali i grumbulluar ose i derdhur shiritat transportues të sistemit, ekskavatorët, paluesit dhe, sipas nevojës, të kryejë punë të tjera ndihmëse.I raporton Prijësit të grupit për pastrim.Është përgjegjës për: Pastrimi i vendpunimit.Ndihma ndaj punëtorëve të tjerë në ekskavator, palues dhe gjatë transportit. Mbështetja gjatë montimit dhe demontimit të shiritave transportues.Duhet të sigurojë pastërtinë e hapësirës nën shiritin kthyes dhe rulat e gomës ose rulat çelikta, duke parandaluar grumbullimin e materialeve, rritjen e barit, grumbullimin e borës dhe akumulimin e materialit pranë hinkave.Është i detyruar të përdorë pajisjet mbrojtëse personale gjatë gjithë kohës së punës, në përputhje me rregulloret e sigurisë.
Duhet të zbatojë urdhrat e pranuara nga prijësi i grupit dhe udhëheqësit e prodhimit në sistem.
Detyra kryesore është pastrimi i konvejerëve në gjatësi dhe largimi i materialeve të grumbulluara rreth mbajtëseve të rulave të gomës ose çeliktë, nën hinkat pranuese dhe në stacionet kthyes, sidomos kur manipuluesit e sistemit nuk arrijnë ta kryejnë këtë punë.Gjatë stinës dimërore, është përgjegjës për pastrimin e lugëve të ekskavatorit dhe hinkave të rrotës punuese duke përdorur vegla të përshtatshme dhe duke qëndruar nën mbikëqyrjen e prijësit të grupit dhe në komunikim të ngushtë me manipuluesin e kabinës 1 të ekskavatorit dhe paluesin.Punët e pastrimit të ekskavatorit dhe hinkave kryhen vetëm kur ekskavatori është i ndalur.
Në pajtim me Ligjet në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative si dhe Rregulloret e brendshme KEK-Sh.A. dhe autorizimeve të dhëna nga Menaxheri i Departamentit përkatës;

Kërkesat profesionale/Kualifikimet
Shkollimi: Shkolla e mesme, minimumi shkolla fillore.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:
Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin** e shkarkuar nga ueb-faqja e KEK-ut e plotësoni dhe, pas plotësimit, duhet ta ngarkoni në formën e aplikimit online te vegëza: **"Ngarko aplikacionin e plotësuar"**, vetëm në formatin tonë që gjendet në ueb-faqen e KEK-ut.

- **Dëshminë për kualifikimin tuaj,** përkatësisht **diplomën e shkollës së mesme,** e skanoni në një dokument të vetëm (format .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe e dërgoni te vegëza **"Dëshmia e kualifikimit"**.

Nëse diploma është fituar jashtë vendit, duhet të dorëzohet vërtetimi i nostrifikimit të diplomës së fituar apo akti që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online. Ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj konsiderohet i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim, kontaktoni në numrat e telefonit: 038 501-401-2671, 045/355 111, ose mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024, plotësim-ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e Punës nr. 804, datë 28.01.2025, për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë	(70) pikë
Intervista vlerësohet deri në njëzet	(20) pikë
Jetëshkrimi (CV) vlerësohet deri në dhjetë	(10) pikë

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me gojë), përparësi do të kenë kandidatët nga Komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara, konform Ligjit nr. 05/L-044.

Për më shumë informata për pozitën e lartpërmendur, vizitoni ueb-faqen: www.kek-energy.com, ikona "Shpallje", ku mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën për të cilën aplikoni.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtari i familjes së ngushtë punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet kjo, aplikacioni juaj do të refuzohet. Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lart do të refuzohen.**

Kalendari i përafërt:

Brenda 25 ditësh testi me shkrim, brenda 30 ditësh intervista me gojë dhe vlerësimi i CV-së. Njoftimi final bëhet brenda 50 ditësh, nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA 01/2024, plotësim-ndryshimit të UA 03/2024 dhe Kodit të Punës nr. 804, datë 28.01.2025.

Data e aplikimit deri më 24.11.2026 ora 24:00

Prishtinë, 09.11.2026

Divizioni i Burimeve Njerëzore